



## I Qershor Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

Sot më 1 qershor, Koalicioni “Bashkë për kujdesin Tërësor të Fëmijëve”, në kuadër të ditës ndërkombëtare të fëmijëve organizoi një aktivitet festiv me rreth 300 fëmijëv nga qendrat ditore të koalicionit si Rromani Baxt, World Vision, VIS Albania, ARSIS, FBSH, Qendra e Fëmijëve të Rrugës, dhe Ndhmë për Fëmijët.

Koalicioni vlerëson dhe përshëndet të gjithë fëmijët dhe ata që kujdesen për ta, që i mbrojnë



nga neglizhimi, dhuna, shfrytëzimi dhe trafikimi.

Kjo ditë na jep mundësinë të reflektojmë mbi punën që ne bëjmë për të mbrojtur fëmijët dhe për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë potencialet e tyre. Njëkohësisht kjo është dhe një mundësi shumë e mirë për organizatat e Shoqërisë Civile si dhe Pushtetin Lokal dhe Qendror të advokojnë për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri,

zbatimin e ligjit Për të Drejtat e Fëmijëve etj.

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve vijon nga “Konferenca Botërore për Mirëqenien e Fëmijëve”, mbajtur në Gjenevë në vitin 1925. Në këtë konferencë ku morën pjesë rreth 54 shtete, u miratua “Deklarata e Gjenevës për Mbrojtjen e Fëmijëve” e cila fokusohet në varfërinë, parandalimin e punës së fëmijëve, arsimimin, dhe çështje të tjera të lidhura me mirëqenien e fëmijëve në të gjithë botën. Mbas kësaj konference shume vende të ndryshme caktuan 1 Qershorin si dita e fëmijëve, për të inkurajuar të gjithë fëmijët, për t'i gëzuar ata si dhe për të tërhequr vëmendjen e të gjithë shoqërisë në çështjet e fëmijëve.

Gjatë aktivitetit të BKTF u organizuan shumë lojra festive në ambjentet e kopshtit zoologjik Tiranë.

Animatorët sociale pikturonin fytyrat e fëmijëve me vizatime sipas dëshirave, bënë lojra kreative me tollumbace formonin kafshë, kapele apo figura të tjera, kënduan dhe kërcyen këngë të ndryshme shqiptare dhe



të huaj, morën pjesë në lojra cirku si dhe u përfshinë në aktivitete të tjera interaktive si bans, lojra me imitime etj.

Grupit të madh të fëmijëve të BKTF iu bashkuan edhe shumë fëmijë nga shkollat e ndryshme të Tiranës si shkolla 26 Nëntori, të cilët kishin ardhur të festonin këtë ditë së bashku me mësuesit e tyre.

Festimi i kësaj dite vazhdon edhe përtej 1 qershorit, pasi Koalicioni BKTF do të organizojë aktivitete ndërgjegjësuese kundër punës së fëmijëve, kundër trafikimit si dhe mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Hyrja e të gjithë fëmijëve nga qendrat e BKTF u mundësua falas nga Bashkia Tiranë dhe ushqimi i fëmijëve u mundësua nga Vodafone Albania.